



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN
AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

Nr. 426 / 01 Prot.

Datë 31.03.2017

Lënda: Mbi kontrollin e përputhshmërisë së dokumenteve të Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Vlorë

Drejtuar: Z. Dritan LELI
Kryetar
Bashkia Vlorë

I nderuar Z. Leli,

Në përgjigje të shkresës Suaj me Nr. 2357 Prot., datë 23.03.2017, protokolluar pranë Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit me Nr. 426 Prot., datë 24.03.2017 me lëndë “Kërkesë për lëshimin e Aktit të Përputhshmërisë, për draftin e PPV për Bashkinë Vlorë”, Ju bëjmë me dijë se:

Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, pas verifikimit të Regjistrit të Integruar të Territorit konstatoi se, Bashkia Vlorë ka botuar vetëm dokumentet e fazës së tretë të PPV (Planin e Zhvillimit dhe Rregulloren), dhe nuk ka bashkëlidhur dokumentet e fazës së parë dhe të dytë (Analizën e Thelluar të Territorit dhe Strategjinë Territoriale). Gjithashtu, mungon edhe materiali në format GIS, për të gjitha fazat.

Për sa më lart, referuar nenit 57 “Miratimi i PPV-së”, pika 8, gërma a) të VKM Nr. 671, datë 29.07.2015 “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, ju bëjmë me dijë se nevojitet botimi i plotë i dokumentacionit të PPV Bashkia Vlorë, në Regjistrin e Integruar të Territorit, në mënyrë që AKPT të nisë shqyrtimin e dokumenteve të saj dhe në bazë të vlerësimit të lëshojë Aktin e Përputhshmërisë.

Me respekt,

Adelina GRECA

DREJTORE E PËRGJITHSHME



Konceptoi, punoi:

B. Laci, E. Pashollari

Datë: 31.03.2017

Nr. Kopje: 2